



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 871/16 prot.

Datë 12.05.2026

V E N D I M
Nr. 629/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2026 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AN&RA” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-70539-11-27-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje materiale të buta”, me fond limit 118,872,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GJERGJI TEXTILE” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ARISA-KONFEKSION” SH.P.K, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BLERINA SADIKU” ShPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Ankimues:** “MALBERTEX & HIMI” SHPK, me NIPT (K71821009N, K22306002C), me BLL.MAGAZINAVE.
- Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “AN&RA” SHPK me NIPT K12205001I dhe adresë Rr.Barikada,Kati 2 Nr.26 Ish kinema 17 Nëntori,Tiranë.
- “GJERGJI TEXTILE” SHPK me NIPT K11409005S dhe adresë Autostrada Tirane Durres, km 12.
- “ARISA- KONFEKSION” SHPK me NIPT J61828068L dhe adresë Rruga Jorgo Plaku, Godina nr.1 (Sukaj), kodi postar 1012, Tiranë.
- “Blerina Sadiku” P.F me NIPT K97730102T dhe adresë Kashar YZBERISH Rruga Rruga Teodor Keko, zone kadastrale 3866 pasuri 298/211-N11.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet tre anëtar, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02-12-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-70539-11-27-2025, me objekt “Loti 1 “Blerje materiale të buta” me fond limit: 118,872,500.00 lekë pa TVSH, parashikuar zhvilluar me datë 13-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara sh.a.

II.2. Në datën 13-02-2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 05.03.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE "ATLANTIK 3" shpk	me vlerë	0	Skualifikuar
2. OE "AN&RA" shpk	me vlerë	79,600,000	Kualifikuar
3. OE "GJERGJI H TEXTILE" shpk	me vlerë	100,783,000	Kualifikuar
4. BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk	me vlerë	105,240,000	Kualifikuar
5. BOE "MALBERTEX" shpk dhe "HIMI" shpk	me vlerë	105,688,500	Kualifikuar
6. OE "Blerina Sadiku" pf	me vlerë	110,540,000	Kualifikuar
7. OE "Bledi Loçi" pf	me vlerë	114,879,000	Skualifikuar
8. OE "UNIVERS PROMOTIONS" shpk	me vlerë	116,700,000	Skualifikuar
9. OE "BREGU COMPANY" shpk	me vlerë	116,835,500	Skualifikuar
10. OE "URBAN FURNITURE" shpk	me vlerë	117,530,000	Skualifikuar

II.4. Në datën 09-03-2026 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak, i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6441, datë 18.03.2026 dhe me nr. protokollit 871/2026 datë 18.03.2026 e operatorit ekonomik “MALBERTEX & HIMI” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-70539-11-27-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje materiale të buta”, me fond limit 118,872,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatorët ekonomik “AN&RA” Shpk; “GJERGJI TEXTILE” SHpk; “ARISA- KONFEKSION” Shpk, “BLERINA SADIKU” PF, në procedurën e sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 871/1 prot., datë 19.03.2026 janë publikuar arsyet dhe pretendimet për operatorët ekonomik “AN&RA” Shpk; “GJERGJI TEXTILE” SHpk; “ARISA- KONFEKSION” Shpk, “BLERINA SADIKU” PF, në procedurën e sipërcituar.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi “AN&RA” Shpk, më datë 24.03.2026 dhe datë 25.03.2026 ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike, protokolluar me tonën me nr.871/2 dhe nr.871/3.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar në këtë procedurë prokurimi “BLERINA SADIKU” PF, më datë 25.03.2026 ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike, protokolluar me tonën me nr.871/4.

II.9. Me shkresën nr. 1462/1 prot, datë 26.03.2026 me objekt “*Vendimi i K.SH.A-së 52/2026 Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK*”, dërguar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 871/5 prot datë 27.03.2026 si dhe shkresën nr. 1462/2 prot, datë 26.03.2026 me objekt “*Vendimi i K.SH.A-së 52/2026 Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK*”, dërguar nëpërmjetë shërbimit postar protokolluar pranë Komisionit

Prokurimit Publik me nr. 871/6 prot datë 30.03.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.10. Më datë 08.04.2026 me shkresën nr.871/7 nga Komisioni i Prokurimit Publik u dërgua kërkesa për informacion të autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, në lidhje me dorëzimin e mostrave për trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik, për procedurën objekt – ankimi.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK në këtë procedurë prokurimi, më datë 09.04.2026 ka dorëzuar argumente shtesë në formë shkresore/në sistemin e ankesave elektronike, protokolluar me tonën me nr.871/8 me objekt “*Objeksion në lidhje me përgjigjen e AK OBP*”.

II.12. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar ka përcjellë me shkresën nr. 1462/4 prot., datë 15.04.2026, protokolluar me tonën me nr.871/9 prot., datë 15.04.2026, informacionin e kërkuar nga KPP së bashku me mostrat, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK.

II.13. Më datë 24.04.2026 me shkresën protokolluar me tonën me nr.871/10 nga operatori ekonomik “AN&RA” Shpk u dërgua kërkesa për verifikim të dokumentacionit te operatori ekonomik ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK, për procedurën objekt – ankimi.

II.14. Më datë 23.04.2026 me shkresën nr.871/10 nga Komisioni i Prokurimit Publik u dërgua kërkesa për informacion te Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në lidhje me akreditimin e nëse Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstililit dhe Lëkurës të Universitetit Politeknik të Tiranës (Laboratori i UPT) për trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik ankimues, për procedurën objekt – ankimi. Gjithashtu po e njëjtja shkresë është dorëzuar nga KPP me datë 04.05.2026 protokolluar me tonën 871/11 me objekt “Ridërgim Kërkese” si më poshte:

“...Sa më sipër, në zbatim të nenit 24/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe neneve 80-86 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 24 pika 2 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe Vendimit Nr.867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj informacion si më poshtë vijon:

- *A ka qënë Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstililit dhe lëkurës të Universitetit Politeknik të Tiranës (Laboratori i UPT), i akredituar prej jush dhe nëse po për kryerjen e cilat testeve dhe me çfarë afati kohor vlefshmërie të certifikatës së akreditimit?*

- *A ka qënë laborator i sipërcituar i akredituar për metodat e testimi të mëposhtme:*

SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional)

SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling)

SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit)

SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë)?

Për sa më sipër kërkuar nëse Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës të Universitetit Politeknik të Tiranës (Laboratori i UPT) ka qënë i akredituar prej jush, lutemi të bashkëlidhni një kopje të certifikatës së akreditimit shoqëruar me listën e analizave për të cilat ka qënë i vlefshëm akreditimi....”

II.15. Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit nëpërmjet shërbimit postar ka përcjellë me shkresën nr. 276/1 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën me nr.871/12 prot., datë 07.05.2026, informacionin e kërkuar nga KPP për trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “MALBERTEX & HIMI” SHPK si më poshtë vijon:

“...Në përgjigje të shkresës suaj nr. 871/10 prot, datë 23.04.2026, "Kërkesë", Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ju informon si më poshtë:

Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ka qënë i akredituar në përputhje me standardin SSH EN ISO/IEC 17025:2017, me certifikate akreditimi me numër regjistrimi LT 110. Data e akreditimit është 05.10.2021 ndërsa certifikata ka qënë e vlefshme deri më datë 04.10.2025.

Lidhur me metodat e testimit të akredituara, ju bëjmë me dije se laborator i sipërcituar ka qënë i akredituar vetëm për metodat e listuara në certifikatën e akreditimit, të cilën e gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese dhe jo për metodat e testimit të mëposhtme:

SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional)

SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling)

SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit)

SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë).”

II.16. Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit nëpërmjet shërbimit postar ka përcjellë përsëri shkresën nr. 276/3 prot., datë 06.05.2026, protokolluar me tonën me nr.871/13 prot., datë 08.05.2026, me informacionin e kërkuar nga KPP me të njëjtën përmbajtje si më sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "MALBERTEX" SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë Kjo kërkesë e shprehur në DST, është një kriter teknik kualifikues me karakter eliminues, pasi ka për qëllim të garantojë që produktet e ofertuar janë verifikuar nga institucione kompetente, (në rastin konkret nga Laboratorë të Akredituar) dhe në përputhje me standardet teknike të kërkuara. Në procedurat e prokurimit publik, dokumentet që provojnë përputhshmërinë teknike të produktit përbëjnë element thelbësor të ofertës, dhe mungesa ose pavlefshmëria e tyre sjell automatikisht mosplotësimin e kriterëve të kualifikimit. Në vazhdim të këtij arsyesimi, shprehim dyshimin tonë të arsyeshëm se analizat e paraqitura nga ana e BOE ARISA KONFEKSION & MUÇA shpk dhe të tjerë në këtë procedurë prokurimi nuk janë në përputhje me kërkesat e kriterëve të veçanta për kualifikim. Analizat e paraqitura nga ky OE sipas informacionit tonë janë të kryera në Laboratorin e Tekstilit të Universitetit të Tiranës. Ky Laboratori nuk ka akreditim për të kryer analiza që prej datës 04.10.2025. Për të provuar këtë pretendim tonin bashkëngjitur kësaj ankese po dërgojmë dokumentat e akreditimit të këtij laboratorit si dhe për të verifikuar pretendimin tonë mund të kontrolloni ëbesite-n e Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Raport testimi që po bashëkngjisim është i lëshuar në emër të MALBERTEX shp dhe mban datën 02.10.2023 për një tjetër procedure prokurimi. Po ta shikoni me kujdes në fund të rreshtit ka një shënim ku thotë: Ky raport testimi është i vlefshëm deri dy muaj pas datës së lëshimit. Raport testimet e paraqitura nga ky OE nuk e kanë më këtë shënim, pikërisht për ti bërë të vlefshme edhe pas dates së lëshimit. Ky fakt është i rëndësishëm pasi bën që analizat e paraqitura nga ky OE të jenë të pavlefshme. Si rrjedhim edhe ofertën e këtij OE e bën të pavlefshme. Vlefshmëria e raportit të testimit është e lidhur drejtpërdrejt me akreditimin e laboratorit dhe si i tillë raporti i testimit konsiderohet dokument teknik i vlefshëm vetëm nëse është lëshuar nga një laborator që: 5. 6. disponon akreditim të vlefshëm, dhe ka në fushën e akreditimit metodat konkrete të testimit të përdorura në analizë. Akreditimi përbën një garanci institucionale të kompetencës teknike të laboratorit dhe një mekanizëm për të siguruar besueshmërinë e rezultateve të testimit. Në mungesë të një akreditimi të vlefshëm, raporti i testimit humbet karakterin e tij si dokument teknik i besueshëm dhe nuk mund të përdoret për të provuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat e DST. KVO ka patur detyrimin ligjor të verifikojë vlefshmërinë dhe autenticitetin e dokumentacionit të paraqitur nga*

operatorët ekonomikë. Në kushtet kur raportit të testimi të lëshuar nga një laborator pa akreditim të vlefshëm të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar paraqesin indicie të forta për pavlefshmëri, KVO-ja kishte detyrimin të kryente verifikim të thelluar pranë institucioneve përkatëse. Në këtë procedurë prokurimi mund të jemi në situatën që analizat e dorëzuara nga ana e këtij OE dhe të tjerëve mund të jenë të lëshuara në datën përpara mbarimit të akreditimit të këtij laboratorit. Në këtë rast ne mendojmë se laboratorit ka dhënë analiza në kushte që përbëjnë shkelje ligjore. Në qoftë se analizat janë në datën e mbarimit të akreditimit, ose para saj, ato nuk mund të jenë të vlefshme për sa kohë që ato janë lëshuar para datës së shpalljes së kësaj procedure prokurimi e cila është shpallur në SPE në datën 02.12.2025 ora 08.00, pra më shumë se dy muaj nga mbarimi i afatit të akreditimit, duke ngritur dyshime për faktin në se është i njëjti material i analizuar me atë të dorëzuar, apo edhe më tej ngre dyshime mbi garancinë për prodhimin e artikujve të kësaj procedure me të njëjtin material. Në cfardo lloj situatë të jenë dhënë analizat për këtë OE dhe për sa kohë që ato janë lëshuar nga ana e Laboratorit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UPT ato janë të pavlefshme. Po marrim rastin kur KVO-ja nuk bën detyrën e saj për të verifikuar vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur dhe nuk arin të verifikojë raport testimet e lëshuara nga Laboratori i UPT dhe i merr ato në konsideratë si të vlefshme në afat, përsëri laboratorit nuk mund të lëshojë raport testimi të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST, ndër të cilat: ? SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional) ? ? ? ? SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling) SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit) SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë) Akreditimi i laboratorëve jepet për metoda konkrete testimi dhe jo në mënyrë të përgjithshme për laboratorin. Nëse një metodë testimi nuk është pjesë e fushës së akreditimit, raporti i analizës për atë metodë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Për pasojë, raportet e testimi të paraqitura nuk përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në DST dhe nuk mund të përdoren për të provuar përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Konkretisht po i marrim me rradhë të gjithë artikujt, përfshi edhe ndryshimet me shtojcat për modifikimin e DST.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

- Gjithashtu në shtojcën 6 të dokumentave të tenderit është parashikuar ndër të tjera si më poshtë vijon:

3. Batanije Teke

Karakteristika të batanijes		
Vetitë	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmeria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Stabiliteti dimensional	Të endura: Baza $\pm 4\%$, Indi $\pm 4\%$; Të thurura: gjatësia $\pm 10\%$, gjerësia $\pm 10\%$	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.

4. Carcafte teke

Karakteristika të këllëfit		
Vetite	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë ≥ 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjerësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.

Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.
Efekti Piling (pushëzimi) 2000 cikle	≥ 4 (pëlhurat e endura) ≥ 3 (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

5.Këllëf jastëku

Karakteristika të këllëfit		
Vetite	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë ≥ 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.

<i>Efekti Piling (pushëzimi) 2000 cikle</i>	≥ 4 (pëlhurat e endura) ≥ 3 (pëlhurat e thurura)	<i>SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)</i>	<i>Nuk duhet të ndizet</i>	<i>SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.</i>

6.Peshqirë duarsh

Karakteristika të Peshqirit		
Vetitë	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
<i>Larje 40°C</i>	<i>Ndryshimi Nota ≥ 4</i>	<i>SSH EN ISO 105-C10:2007ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Fërkim</i>	<i>Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë ≥ 3</i>	<i>SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Stabiliteti dimensional</i>	<i>Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%</i>	<i>SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)</i>	<i>Baza ≥ 300 N; Indi ≥ 300 N;</i>	<i>SSH EN ISO 13934-1:2013ose ekuivalentin e tij.</i>

.... Të gjitha shpenzimet laboratorike për fletë analizat për artikujt e lartpërmendur, do të përballohen nga firma.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.”

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Raport Testimi nr. A2-4-15, më datë 04/10/2025 nga Universiteti Politeknik të Tiranës (Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik I Tektilit dhe Lëkurës, si më poshtë:

Dërguar nga..... **ARISA KONFEKSION**
 Adresa..... **TIRANË**
 Vendi i marrjes së kampionit..... **F14**
 Data e ardhjes së kampionit..... **01/10/2025**
 Data e kryerjes së testimit..... **09/10/2025**

Nga testimi i Kampionit Nr. **A2-415** ardhur në datë **01/10/2025**, rezulton se përfaqëson artikullin:

Nr.	Emërtimi i testimit	Metoda	Rezultati	Pasiguria stand.	Njësia
1.	Përcaktimi i gjerësisë dhe gjatësisë	S SH ISO 22198:2006		± ±	cm
2.	Përcaktimi i dendësisë bazë dhe ind	ISO 7211/2:1984		± ±	fije/10cm
3.	Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në këputje sipas bazës dhe indit	ISO 13934-1:2003		± ±	N
4.	Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në grisje sipas bazës dhe indit	ISO 13937-2:2000		± ±	mm
5.	Përcaktimi i masës	ISO 3801:2013		± ±	N
6.	Përcaktimi i trashësisë	EN ISO 5084:1996		± ±	g/m ²
7.	Përcaktimi i lagështisë	S SH ISO 17617:2014		± ±	mm
8.	Përcaktimi i përbërjes	ISO 1833, 5088		± ±	%
9.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C	ISO 105-C10:2007			%
10.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C	ISO 105-C03:1989			
11.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 95°C	ISO 105-C05:1989			
12.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të thatë	ISO 105-X12:2001			
13.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të njomë	ISO 105-X12:2001 ISO 105-A02:1994			
13/1	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të njomë	ISO 105-X12:2001 ISO 105-A03:1994			
14.	Përcaktimi i hollësisë së fillit (N _m)	S SH 659-2:1988		± ±	
15.	Përcaktimi i hollësisë së fillit (T _{tex})	S SH 659-2:1988		± ±	
16.	Përcaktimi i llojit të thurjes	ISO 7211/1:1984			

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuarra, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me pretendimin e operatorit ankimes për skualifikimin e BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk se: *"...përsëri laboratorit nuk mund të lëshojë raport testime të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë*

metodash testimi të kërkuara në DST, ndër të cilat: ? SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional) ? ? ? ? ? SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling) SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit) SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë) Akreditimi i laboratorëve jepet për metoda konkrete testimi dhe jo në mënyrë të përgjithshme për laboratorin.”, nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk Komisioni konstaton, se BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk ka dorëzuar në SPE dokumentin e listuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Referuar arsyes së pretenduar për skualifikimin e operatorit BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 7 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka përcaktuar: kërkesën për Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta), dhe sipas shtojcës 6 janë kërkuar **Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij të përcaktuara në pikën III.1.1 të këtij vendimi**. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “MALBERTEX & HIMI” SHPK se “laboratori nuk mund të lëshojë raport testimi të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST...” si dhe nga përgjigja e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit se Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ka qenë i akredituar vetëm për metodat e listuara në certifikatën e akreditimit...dhe jo për metodat e testimit të mëposhtme:

SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional)

SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling)

SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit)

SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë), qartazi konfirmohet se Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nuk arrin të përmbushë kriteri kualifikues sipas DST-së së kërkuar nga autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk pasi Raport Testimet janë të lëshuara nga subjekte të paakredituara, pasi si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk, si dhe në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve u kërkuar verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 4 të tij thuhet se “Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit

të konformitetit” vetë ka pohuar se Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nuk ka qënë i akredituar për metoda e testimit të dorëzuara nga BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk për të cili ka ngritur pretendime operatori ekonomik ankimues. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”. Pra për faj të vetë operatorit ekonomik nuk është arritur të përmbushet kriteri i sipërcituar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se për sa kohë ekzistojnë laboratore të akredituara **kombëtar ose ndërkombëtar** për fushat e akreditimit dhe për metodat e testimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi. Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE "ARISA-KONFEKSION" shpk dhe "MUCA" shpk me arsyet: *“Bazuar në mungesën e aksesit në mostrat fizike dhe dokumentacionin e verifikueshëm nga BOE ARISA-KONFEKSION & MUÇA shpk , nuk mund të konfirmohet në mënyrë të besueshme se logoja e kërkuar për artikujt (çarçaf, kllëf jastëku, batanie, peshqir) është realizuar sipas specifikimeve teknike të DST, duke përfshirë kërkesën që të jetë e endur gjatë procesit të prodhimit. Ky mosverifikim përbën mosplotësim të pikës 2.3.9 të DST-së dhe pengon vlerësimin e saktë të ofertës. Mos bërja e logos me endje që në prodhim e bën të pa plotë realizimin e kërkesës së pikës 2.3.9 të kërkesave të veçanta për kualifikim. Nisur nga sa pretenduam më sipër, kërkojmë skualifikimin e ofertës së BOE ARISA-KONFEKSION & MUÇA shpk... Për arsye se ne nuk kemi akses në dokumentat e tenderit të paraqitura nga ana e këtij OE, shprehim dyshimin tonë të arsyeshëm se ky OE nuk plotëson kriteret kualifikues të pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.6, 2.3.8”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm

i ankimesit qëndron, dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik BOE “ARISA KONFEKSION & MUÇA” shpk pas arsytimit të KPP do të jetë i skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese, nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik “ARISA KONFEKSION & MUÇA” shpk, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “MALBERTEX & HIMI” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga OE “GJERGJI TEXTILE” shpk, me arsyen se: *“Analizat e paraqitura nga ky OE sipas informacionit tonë janë të kryera në Laboratorin e Tekstilit të Universitetit të Tiranës. Ky Laboratori nuk ka akreditim për të kryer analiza që prej datës 04.10.2025. Për të provuar këtë pretendim tonin bashkëngjitur kësaj ankese po dërgojmë dokumentat e akreditimit të këtij laborator si dhe për të verifikuar pretendimin tonë mund të kontrollojmë në internetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Raport testimi që po bashkëngjisim është i lëshuar në emër të MALBERTEX shp dhe mban datën 02.10.2023 për një tjetër procedurë prokurimi. Po ta shikoni me kujdes në fund të rreshtit ka një shënim ku thotë: Ky raport testimi është i vlefshëm deri dy muaj pas datës së lëshimit. Raport testimet e paraqitura nga ky OE nuk e kanë më këtë shënim, pikërisht për ti bërë të vlefshme edhe pas datës së lëshimit. Ky fakt është i rëndësishëm pasi bën që analizat e paraqitura nga ky OE të jenë të pavlefshme. Si rrjedhim edhe ofertën e këtij OE e bën të pavlefshme. Vlefshmëria e raportit të testimit është e lidhur drejtpërdrejt me akreditimin e laboratorit dhe si i tillë raporti i testimit konsiderohet dokument teknik i vlefshëm vetëm nëse është lëshuar nga një laborator që: 3. disponon akreditim të vlefshëm, dhe ka në fushën e akreditimit metodat konkrete të testimit të përdorura në analizë. Akreditimi përbën një garanci institucionale të kompetencës teknike të laboratorit dhe një mekanizëm për të siguruar besueshmërinë e rezultateve të testimit. Në mungesë të një akreditimi të vlefshëm, raporti i testimit humbet karakterin e tij si dokument teknik i besueshëm dhe nuk mund të përdoret për të provuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat e DST. KVO ka patur detyrimin ligjor të verifikojë vlefshmërinë dhe autenticitetin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në kushtet kur raportit të testimit të lëshuar nga një laborator pa akreditim të vlefshëm të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar paraqesin indicie të forta për pavlefshmëri, KVO-ja kishte detyrimin të kryente verifikim të thelluar pranë institucioneve përkatëse. Në këtë procedurë prokurimi mund të jemi në situatën që analizat e dorëzuara nga ana e këtij OE dhe të tjerëve mund të jenë të lëshuara në datën përpara mbarimit të akreditimit të këtij laborator. Në këtë rast ne mendojmë se laboratori ka dhënë analiza në kushte që përbëjnë shkelje ligjore. Në qoftë se analizat janë në datën e mbarimit të akreditimit, ose para saj, ato nuk mund të jenë të vlefshme për sa kohë që ato janë lëshuar para datës së shpalljes së kësaj procedure prokurimi e cila është shpallur në SPE në datën 02.12.2025 ora 08.00, pra më shumë se dy muaj nga mbarimi i afatit të akreditimit, duke ngritur dyshime për faktin nëse është i njëjti material i analizuar me atë të dorëzuar, apo edhe më tej ngre dyshime mbi garancinë për prodhimin e artikujve të kësaj procedure me të njëjtin material. Në çfarëdo lloj situatë të jenë dhënë analizat për këtë OE dhe për sa kohë që ato janë lëshuar nga ana e Laboratorit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UPT ato janë të pavlefshme. Po marrim rastin kur KVO-ja nuk bën detyrën e saj për të verifikuar vlefshmërinë e dokumentacionit të*

paraqitur dhe nuk arin të verifikojë raport testimet e lëshuara nga Laboratori i UPT dhe i merr ato në konsideratë si të vlefshme në afat, përsëri laboratorit nuk mund të lëshojë raport testimet të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST, ndër të cilat: ? SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional) ? ? ? ? ? SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling) SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit) SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë) Akreditimi i laboratorëve jepet për metoda konkrete testimi dhe jo në mënyrë të përgjithshme për laboratorin. Nëse një metodë testimi nuk është pjesë e fushës së akreditimit, raporti i analizës për atë metodë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Për pasojë, raportet e testimit të paraqitura nuk përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në DST dhe nuk mund të përdoren për të provuar përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Konkretisht po i marrim me rradhë të gjithë artikujt, përfshi edhe ndryshimet me shtojcat për modifikimin e DST.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

- Gjithashtu në shtojcën 6 të dokumentave të tenderit është parashikuar ndër të tjera si më poshtë vijon:

3. Batanije Teke

Karakteristika të batanijes		
Vetitë	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Stabiliteti dimensional	Të endura: Baza $\pm 4\%$, Indi $\pm 4\%$; Të thurura: gjatësia $\pm 10\%$, gjerësia $\pm 10\%$	SSH EN ISO 3759:2011ose ekuivalentin e tij.

Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934- 1:2013 ose ekuivalentin e tij.
--	--	--

4.Çarçafte teke

Karakteristika të këllëfit		
Vetite	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë ≥ 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$; Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.
Efekt Piling (pushëzimi) 2000 cikle	≥ 4 (pëlhurat e endura) ≥ 3 (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

5.Këllëf jastëku

Karakteristika të këllëfit		
Vetite	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë ≥ 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.
Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$; Pëlhura të thurura: gjatësia $+ 2\%$ deri -5% , gjërësia $+5\%$ deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.
Efekt Piling (pushëzimi) 2000 cikle	≥ 4 (pëlhurat e endura) ≥ 3 (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

6.Peshqirë duarsh

Karakteristika të Peshqirit		
Vetitë	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		

Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Në të njomë ≥ 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Stabiliteti dimensional	Pëlhura të endura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza $\geq 300 N$; Indi $\geq 300 N$;	SSH EN ISO 13934-1:2013ose ekuivalentin e tij.

.... Të gjitha shpenzimet laboratorike për fletë analizat për artikujt e lartpërmendur, do të përballohen nga firma.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.”

III.3.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “GJERGJI TEXTILE” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Raport Testimi nr. A2-330, më datë 29/12/2025 nga Universiteti Politeknik të Tiranës (Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik I Tekstil dhe Lëkurës), si më poshtë:

Dërguar nga Gjergji - H Textile
 Adresa 1. RRETTI
 Vendi i marrjes së kampionit 1. RRETTI
 Data e ardhjes së kampionit 29/12/2025
 Data e kryerjes së testimit 29/12/2025

Nga testimi i Kampionit Nr. A-330 kryer në datë 29/12/2025, rezultoni se përfaqëson artikullin: Peshqir

Nr.	Emërtimi i testimit	Metoda	Rezultati	Pasiguria stand.	Shtesa
1.	Përçaktimi i gjërësisë dhe gjatësisë	S SH ISO 22198:2006	C	± ±	mm
2.	Përçaktimi i dendësisë bazë dhe ind	ISO 7211/2:1984	B	± ±	fje/10cm
3.	Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në këputje sipas bazës dhe indit	ISO 13934-1:2003	B	± ±	N
4.	Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në grisje sipas bazës dhe indit	ISO 13937-2:2000	B	± ±	N
5.	Përçaktimi i masës	ISO 3801:2013	M	±	g/m ²
6.	Përçaktimi i trashësisë	EN ISO 5084:1996		±	mm
7.	Përçaktimi i lagështisë	S SH ISO 17617:2014		±	%
8.	Përçaktimi i përbërjes	ISO 1833, 5088		±	%
9.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C	ISO 105-C10:2007	N		
10.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C	ISO 105-C03:1989	N		
11.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 95°C	ISO 105-C05:1989	N		
12.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të thatë	ISO 105-X12:2001	N		
13.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të njomë	ISO 105-X12:2001 ISO 105-A02:1994	N		
13/1	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të njomë	ISO 105-X12:2001 ISO 105-A03:1994	N		
14.	Përçaktimi i hollësisë së fillit (Nm)	S SH 659-2:1988	N	± ±	
15.	Përçaktimi i hollësisë së fillit (Tm)	S SH 659-2:1988	T	± ±	
16.	Përçaktimi i llojit të thurjes	ISO 7211/1:1984			

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.3.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose

kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepron në mënyrë të transparente e në mënyrë proporcionale.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me pretendimin e operatorit ankimues për skualifikimin e OE “GJERGJI TEXTILE” SHPK se: *“...përsëri laboratorit nuk mund të lëshojë raport testimi të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST, ndër të cilat: ? SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional) ? ? ? ? SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling) SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit) SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë) Akreditimi i laboratorëve jepet për metoda konkrete testimi dhe jo në mënyrë të përgjithshme për laboratorin.”*, nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga OE “GJERGJI TEXTILE” SHPK, Komisioni konstaton, se OE “GJERGJI TEXTILE” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentin e listuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Referuar arsyes së pretenduar për skualifikimin e operatorit “GJERGJI TEXTILE” SHPK Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 7 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka përcaktuar: kërkesën për Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta), dhe sipas shtojcës 6 janë kërkuar **Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij të përcaktuara në pikën III.3.1 të këtij vendimi**. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe

nënljigjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK se “laboratori nuk mund të lëshojë raport testimi të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST...” si dhe nga përgjigja e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit se Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ka qenë i akredituar vetëm për metodat e listuara në certifikatën e akreditimit... dhe jo për metodat e testimit të mëposhtme:

SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional)

SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling)

SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit)

SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë), qartazi konfirmohet se Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nuk arrin të përmbushë kriteri kualifikues sipas DST-së së kërkuar nga autoriteti kontaktor nga operatori ekonomik “GJERGJI TEXTILE” SHPK pasi Raport Testimet janë të lëshuara nga subjekte të paakredituara, pasi si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “GJERGJI TEXTILE” SHPK, si dhe në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve u kërkuar verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 4 të tij thuhet se “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit” vetë ka pohuar se Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nuk ka qenë i akredituar për metoda e testimit të dorëzuara nga OE “GJERGJI TEXTILE” SHPK për të cilin ka ngritur pretendime operatori ekonomik ankimues. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik OE “GJERGJI TEXTILE” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”. Pra për faj të vetë operatorit ekonomik nuk është arritur të përmbushet kriteri i sipërcituar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se për sa kohë ekzistojnë labore të akredituara **kombëtar ose ndërkombëtar** për fushat e akreditimit dhe për metodat e testimit të kërkuara nga autoriteti kontaktor, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “GJERGJI TEXTILE” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të

provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik "GJERGJI TEXTILE" SHPK është në kushtet e mospërmblotjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi. Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "MALBERTEX & HIMI" SHPK qëndron.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues "MALBERTEX & HIMI" SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues "MALBERTEX & HIMI" SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik OE GJERGJI TEXTILE shpk me arsyet: *"Për arsye se ne nuk kemi akses në dokumentat e tenderit të paraqitura nga ana e këtij OE, shprehim dyshimin tonë të arsyeshën se ky OE nuk plotëson kriteret kualifikues të pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.6, 2.3.8.... Bazuar në mungesën e aksesit në mostrat fizike dhe dokumentacionin e verifikueshëm nga OE, nuk mund të konfirmohet në mënyrë të besueshme se logoja e kërkuar për artikujt (çarçaf, kllëf jastëku, batanie, peshqir) është realizuar sipas specifikimeve teknike të DST, duke përfshirë kërkesën që të jetë e endur gjatë procesit të prodhimit. Ky mosverifikim përbën mosplotësim të pikës 2.3.9 të DST-së dhe pengon vlerësimin e saktë të ofertës. Mos bërja e logos me endje që në prodhim e bën të pa plotë realizimin e kërkesës së pikës 2.3.9 të kërkesave të veçanta për kualifikim. Nisur nga sa pretenduam më sipër, kërkojmë skualifikimin e ofertes së OE GJERGJI TEXTILE sh.p.k", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërme i ankimuesit qëndron, dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "GJERGJI TEXTILE" shpk pas arsyetimit të KPP do të jetë i skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese, nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik "GJERGJI TEXTILE" shpk, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.*

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "MALBERTEX & HIMI" SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga OE "AN&RA" SHPK, me arsyen se: *"Analizat e paraqitura nga ky OE sipas informacionit tonë janë të kryera në Laboratorin e Tekstil të Universitetit të Tiranës. Ky Laboratori nuk ka akreditim për të kryer analiza që prej datës 04.10.2025. Për të provuar këtë pretendim tonin bashkëngjitur kësaj ankese po dërgojmë dokumentat e akreditimit të këtij laborator si dhe për të verifikuar pretendimin tonë mund të kontrolloni ëbesite-n e Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Raport testimi që po bashkëngjisim është i lëshuar në emër të MALBERTEX shp dhe mban datën 02.10.2023 për një tjetër procedure prokurimi. Po ta shikoni me kujdes në fund të rreshtit ka një shënim ku thotë: Ky raport testimi është i vlefshëm deri dy muaj pas datës së lëshimit. Raport testimet e paraqitura nga ky OE nuk e kanë më këtë shënim, pikërisht për ti bërë të vlefshme edhe pas dates së lëshimit Ky fakt është i rëndësishëm pasi bën që analizat e*

paraqitura nga ky OE të jenë të pavlefshme. Si rrjedhim edhe ofertën e këtij OE e bën të pavlefshme. Vlefshmëria e raportit të testimit është e lidhur drejtpërdrejt me akreditimin e laboratorit dhe si i tillë raporti i testimit konsiderohet dokument teknik i vlefshëm vetëm nëse është lëshuar nga një laborator që: 1. 2. disponon akreditim të vlefshëm, dhe ka në fushën e akreditimit metodat konkrete të testimit të përdorura në analizë. Akreditimi përbën një garanci institucionale të kompetencës teknike të laboratorit dhe një mekanizëm për të siguruar besueshmërinë e rezultateve të testimit. Në mungesë të një akreditimi të vlefshëm, raporti i testimit humbet karakterin e tij si dokument teknik i besueshëm dhe nuk mund të përdoret për të provuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat e DST. KVO ka patur detyrimin ligjor të verifikojë vlefshmërinë dhe autenticitetin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në kushtet kur raportit të testimit të lëshuar nga një laborator pa akreditim të vlefshëm të paraqitura nga operatorët ekonomikë të kualifikuar paraqesin indicie të forta për pavlefshmëri, KVO-ja kishte detyrimin të kryente verifikim të thelluar pranë institucioneve përkatëse. Në këtë procedurë prokurimi mund të jemi në situatën që analizat e dorëzuara nga ana e këtij OE dhe të tjerëve mund të jenë të lëshuara në datën përpara mbarimit të akreditimit të këtij laboratorit. Në këtë rast ne mendojmë se laboratorit ka dhënë analiza në kushte që përbëjnë shkelje ligjore. Në qoftë se analizat janë në datën e mbarimit të akreditimit, ose para saj, ato nuk mund të jenë të vlefshme për sa kohë që ato janë lëshuar para datës së shpalljes së kësaj procedure prokurimi e cila është shpallur në SPE në datën 02.12.2025 ora 08.00, pra më shumë se dy muaj nga mbarimi i afatit të akreditimit, duke ngritur dyshime për faktin nëse është i njëjti material i analizuar me atë të dorëzuar, apo edhe më tej ngre dyshime mbi garancinë për prodhimin e artikujve të kësaj procedure me të njëjtin material. Në çfardo lloj situate të jenë dhënë analizat për këtë OE dhe për sa kohë që ato janë lëshuar nga ana e Laboratorit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të UPT ato janë të pavlefshme. Po marrim rastin kur KVO-ja nuk bën detyrën e saj për të verifikuar vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur dhe nuk arin të verifikojë raport testimet e lëshuara nga Laboratori i UPT dhe i merr ato në konsideratë si të vlefshme në afat, përsëri laboratorit nuk mund të lëshojë raport testime të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezulton se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST, ndër të cilat: ? SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional) ? ? ? ? ? SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling) SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit) SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë) Akreditimi i laboratorëve jepet për metoda konkrete testimi dhe jo në mënyrë të përgjithshme për laboratorin. Nëse një metodë testimi nuk është pjesë e fushës së akreditimit, raporti i analizës për atë metodë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Për pasojë, raportet e testimit të paraqitura nuk përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në DST dhe nuk mund të përdoren për të provuar përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Konkretisht po i marrim me rradhë të gjithë artikujt, përfshi edhe ndryshimet me shtojcat për modifikimin e DST.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

- Gjithashtu në shtojcën 6 të dokumentave të tenderit është parashikuar ndër të tjera si më poshtë vijon:

3. Batanije Teke

Karakteristika të batanijes		
Vetitë	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Ndryshimi dimensional		
Stabiliteti dimensional	Të endura: Baza $\pm 4\%$, Indi $\pm 4\%$; Të thurura: gjatësia $\pm 10\%$, gjerësia $\pm 10\%$	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.

4. Carcafte teke

Karakteristika të këllëfit		
Vetite	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë ≥ 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Zbardhje (peroksid)	Ndryshimi Nota ≥ 4	SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.

<i>Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)</i>	<i>Ndryshimi Nota ≥ 4</i>	<i>SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Ndryshimi dimensional</i>		
<i>Larje + Tharje</i>	<i>Pëlhura tëendura: Baza $\pm 5\%$, Indi $\pm 5\%$; Pëlhura tëthurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%</i>	<i>SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Qëndrueshmeria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)</i>	<i>Baza ≥ 400 N; Indi ≥ 400 N;</i>	<i>SSH EN ISO 13934-1:2013 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Efkti Piling (pushëzimi) 2000 cikle</i>	<i>≥ 4 (pëlhurat e endura) ≥ 3 (pëlhurat e thurura)</i>	<i>SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)</i>	<i>Nuk duhet të ndizet</i>	<i>SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.</i>

5.Këllëf jastëku

<i>Karakteristika të këllëfit</i>		
<i>Vetite</i>	<i>Kërkesa</i>	<i>Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Qëndrueshmëria e ngjyrës</i>		
<i>Larje 40°C</i>	<i>Ndryshimi Nota ≥ 4</i>	<i>SSH EN ISO 105-C10:2007 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Fërkim</i>	<i>Në të thatë $\geq 3-4$ Nëtënjomë ≥ 3</i>	<i>SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Zbardhje (peroksid)</i>	<i>Ndryshimi Nota ≥ 4</i>	<i>SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Djersë (Tretesire Acide dhe Bazike)</i>	<i>Ndryshimi Nota ≥ 4</i>	<i>SSH EN ISO 105-E04:2013 ose ekuivalentin e tij.</i>
<i>Ndryshimi dimensional</i>		

Larje + Tharje	Pëlhura të endura: Baza \pm 5% , Indi \pm 5% ;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza \geq 400 N; Indi \geq 400 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013ose ekuivalentin e tij.
Efekti Piling (pushëzimi) 2000 cikle	\geq 4 (pëlhurat e endura) \geq 3 (pëlhurat e thurura)	SSH EN ISO 12947-2:2016 ose ekuivalentin e tij.
Sjellja ndaj zjarrit (ku specifikohet)	Nuk duhet të ndizet	SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij.

6.Peshqirë duarsh

Karakteristika të Peshqirit		
Vetitë	Kërkesa	Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria e ngjyrës		
Larje 40°C	Ndryshimi Nota \geq 4	SSH EN ISO 105-C10:2007ose ekuivalentin e tij.
Fërkim	Në të thatë \geq 3-4 Në të njomë \geq 3	SSH EN ISO 105-X12:2016 ose ekuivalentin e tij.
Stabiliteti dimensional	Pëlhura të endura: Baza \pm 5% , Indi \pm 5% ;Pëlhura të thurura: gjatësia + 2% deri -5%, gjërësia +5% deri -8%	SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij.
Qëndrueshmëria në tërheqje (vetëm për pëlhurat e endura)	Baza \geq 300 N; Indi \geq 300 N;	SSH EN ISO 13934-1:2013ose ekuivalentin e tij.

.... Të gjitha shpenzimet laboratorike për fletë analizat për artikujt e lartpërmendur, do të përballohen nga firma.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.”

III.5.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “AN&RA” SHPK, ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Raport Testimi nr. A2-4-11, më datë 04/10/2025 nga Universiteti Politeknik të Tiranës (Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik I Tekstil dhe Lëkurës, si më poshtë

Dërguar nga..... **AN&RA**
 Adresa..... **TIRANË**
 Vendi i marrjes së kampionit..... **FIM**
 Data e ardhjes së kampionit **1/10/2025**
 Data e kryerjes së testimit **6/10/2025**

Nga testimi i Kampionit Nr. **A2-411** ardhur në datë **1/10/2025**, rezulton se përfaqëson artikullin:

Nr.	Emërtimi i testimit	Metoda	Rezultati	Pasiguria stand.	Njësia
1.	Përcaktimi i gjerësisë dhe gjatësisë	S SH ISO 22198:2006		± ±	cm
2.	Përcaktimi i dendësisë bazë dhe ind	ISO 7211/2:1984		± ±	fije/10cm
3.	Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në këputje sipas bazës dhe indit	ISO 13934-1:2003		± ±	N
4.	Qëndrueshmëria dhe elasticiteti në grisje sipas bazës dhe indit	ISO 13937-2:2000		± ±	N
5.	Përcaktimi i masës	ISO 3801:2013		±	g/m ²
6.	Përcaktimi i trashësisë	EN ISO 5084:1996		±	mm
7.	Përcaktimi i lagështisë	S SH ISO 17617:2014		±	%
8.	Përcaktimi i përbërjes	ISO 1833, 5088			%
9.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 40°C	ISO 105-C10:2007			
10.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 60°C	ISO 105-C03:1989			
11.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje 95°C	ISO 105-C05:1989			
12.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të thatë	ISO 105-X12:2001			
13.	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të njomë	ISO 105-X12:2001 ISO 105-A02:1994			
13/1	Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim të njomë	ISO 105-X12:2001 ISO 105-A03:1994			
14.	Përcaktimi i hollësisë së fillit (N _m)	S SH 659-2:1988		± ±	
15.	Përcaktimi i hollësisë së fillit (T _{tex})	S SH 659-2:1988		± ±	
16.	Përcaktimi i llojit të thurjes	ISO 7211/1:1984			

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe

judiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të

trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.5.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.5.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton se, duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me pretendimin e operatorit ankimues për skualifikimin e OE “AN&RA” SHPK se: “...përsëri laboratorit nuk mund të lëshojë raport testimi të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezultoi se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST, ndër të cilat: ? SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional) ? ? ? ? SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling) SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit) SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje) SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë) Akreditimi i laboratorëve jepet për metoda konkrete testimi dhe jo në mënyrë të përgjithshme për laboratorin.” nga verifikimi i dokumentave të tenderit si dhe dokumentave të ngarkuara në SPE nga OE “AN&RA” SHPK Komisioni konstaton, se OE “AN&RA” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentin e listuar në pikën III.5.2 të këtij vendimi. Referuar arsyes së pretenduar për skualifikimin e operatorit OE “AN&RA” SHPK Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në pikën 7 të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka përcaktuar: kërkesën për Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta), dhe sipas shtojcës 6 janë kërkuar **Metodat testuese sipas Standardeve SSH EN ISO ose ekuivalentin e tij të përcaktuara në pikën III.5.1 të këtij vendimi.** Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK se “laboratorit nuk mund të lëshojë raport testimi të vlefshmesipas kërkesave për testim të kërkuara në shtojcën 6 të DST-së, pasi rezultoi se ai nuk ka akreditim për një sërë metodash testimi të kërkuara në DST...” si dhe nga përgjigja e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit se Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, ka qenë i akredituar vetëm për metodat e listuara në certifikatën e akreditimit... dhe jo për metodat e testimit të mëposhtme:

SSH EN ISO 3759:2011 ose ekuivalentin e tij (Stabiliteti dimensional)

SSH EN ISO 12947-2 : 2016 ose ekuivalentin e tij (Efekti piling)

SSH EN ISO 6941:2003 ose ekuivalentin e tij (Sjellja ndaj zjarrit)

SSH EN ISO 105-X12 :2016 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në fërkim)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në zbardhje)

SSH EN ISO 105-N02:2007 ose ekuivalentin e tij (Qëndrueshmëria në djersë), qartazi konfirmohet se Raport Testimi (fletë-analizë) për artikujt objekt prokurimi të lëshuar nga laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nuk arrin të përmbushë kriteri kualifikues sipas DST-së së kërkuar nga autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik OE “AN&RA” SHPK pasi Raport Testimet janë të lëshuara nga subjekte të paakredituara, pasi si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “AN&RA” SHPK, si dhe në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve u kërkuar verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 4 të tij thuhet se “Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit” vetë ka pohuar se Laboratori Fiziko-Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës nuk ka qënë i akredituar për metoda e testimit të dorëzuara nga OE “AN&RA” SHPK për të cili ka ngritur pretendime operatori ekonomik ankimes. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “AN&RA” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”. Pra për faj të vetë operatorit ekonomik nuk është arritur të përmbushet kriteri i sipërcituar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se për sa kohë ekzistojnë labore të akredituara **kombëtar ose ndërkombëtar** për fushat e akreditimit dhe për metodat e testimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “AN&RA” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “AN&RA” SHPK është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi. Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “MALBERTEX & HIMI” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "AN&RA" shpk me arsyet: “Nuk plotëson kriterin 2.3.2 të kapaciteti Teknik... Në dijeninë tonë ky OE nuk është prodhues. Ne shprehim dyshimin tonë të arsyeshëm se ky kriter nuk plotësohet nga ana e tij, si rrjedhim nuk plotëson kërkesën për kualifikim... Për arsye se ne nuk kemi akses në dokumentat e tenderit të paraqitura nga ana e këtij OE, shprehim dyshimin tonë të arsyeshëm se ky OE nuk plotëson kriteret kualifikues të pikave 2.3.3, 2.3.4, 2.3.6, 2.3.8... Bazuar në mungesën e aksesit në mostrat fizike dhe dokumentacionin e verifikueshëm nga OE, nuk mund të konfirmohet në mënyrë të besueshme se logoja e kërkuar për artikujt (çarçaf, kllëf jastëku, batanie, peshqir) është realizuar sipas specifikimeve teknike të DST, duke përfshirë kërkesën që të jetë e endur gjatë procesit të prodhimit. Ky mosverifikim përbën mosplotësim të pikës 2.3.9 të DST-së dhe pengon vlerësimin e saktë të ofertës. Mos bërija e logos me endje që në prodhim e bën të pa plotë realizimin e kërkesës së pikës 2.3.9 të kërkesave të veçanta për kualifikim.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërme të ankimuesit qëndron, dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "AN&RA" shpk pas arsytimit të KPP do të jetë i skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese, nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik "AN&RA" shpk, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit BOE ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BLERINA SADIKU” PF, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilët paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike. Sa më sipër, pretendimet e operatorit BOE ankimues “MALBERTEX & HIMI” SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BLERINA SADIKU” PF, nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MALBERTEX & HIMI” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-70539-11-27-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje materiale të buta”, me fond limit 118,872,500.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 13-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat e operatorëve ekonomik “ARISA-KONFEKSION” SH.P.K, operatori ekonomik “GJERGJI TEXTILE” SHPK si dhe operatori ekonomik “AN&RA” SHPK, në baze të konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MALBERTEX & HIMI” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

